



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE TË KOSOVËS



Qeveria e Kosovës
Minsitria e Shërbimeve Publike
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Raport sektorial

Raporti i zhvillimit hapësinor për sektorin e

EMERGJENCËS

Prishtinë, tetor 2004

Draft / dokument pune
Raport i sektorial i zhvillimit hapësinor për sektorin e emergjencës

Menaxhimi i emergjencave

Hartues të draftit / dokumentit punues

Hysen Hysenaj, Kryesues i sektorit të parandalimit, MSHP, DME
Alush Zeqiri, zyrtar i planifikimit emergjent, MSHP, DME
Mimoza Kallaba, hulumtuese profesionale, MMPH, IPH

Prishtinë, tetor 2004

HYRJE

Përpilimi dhe hartimi i Raportit Sektorial bazohet në ligjin për Planifikim Hapësinor në të cilin thuhet se Plani Hapësinor i Kosovës është plan strategjik multisektorial, i cili bazohet në raportet e sektorëve të rëndësishëm të përgatitura nga ministritë kompetente të Qeverisë së Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë, merr parasysh strategjitë zhvillimore për sektorë të ndryshëm duke përfshirë financat, arsimin e lartë dhe studimet, telekomunikacionin, transportet, minierat, prodhimin e energjisë, burimet natyrore, tokat më cilësore, sportin dhe rekreacionin.

PROFILI SEKTORIAL, ÇËSHTJET, SFIDAT

Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave është përgjegjës për menaxhimin e emergjencave të nivelit qeveritar, vënien e standardeve për kryerjen e punës lidhur me gatishmërinë civile dhe reagimit emergjent në Kosovë dhe koordinimin e autoriteteve komunale për gatishmëri emergjente, varësisht nga karakteri dhe përmasat e fatkeqësisë (katastrofës).

Në strukturat e përhershme Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave ka katër divizione:

- Divizioni i Planifikimit dhe Parandalimit,
- Divizioni i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit,
- Divizioni i Reagimit të Shpejt,
- Qendra Nacionale e Alarmimit dhe Koordinimit Emergjent-QNAKE I12

Departamenti është autoriteti më i lartë për zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë për gatishmëri emergjente dhe civile në Kosovë, në bashkëpunim të ngushtë me ministritë e tjera dhe komunat.

Detyrat kryesore janë:

- Të hartojë strategjitë e përgjithshme për zhvillimin, promovimin, parandalimin dhe reagimin në raste emergjente;
- Të hartojë vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut për Kosovën dhe planin e përgjithshëm për gatishmëri dhe reagim emergjent në Kosovë;
- Vënien e standardeve lidhur me gatishmërinë civile dhe reagimin emergjent në Kosovë;
- Të këshillojë autoritetet qeveritare dhe publike në lidhje me gatishmërinë dhe reagimin emergjent;
- Të themelojë Bordin Këshillues të Shërbimeve Emergjente për mbikëqyrjen e aktiviteteve të shërbimeve emergjente komunale;
- Koordinon dhe organizon punën për përpilimin e marrëveshjeve, protokolleve dhe planeve të bashkëpunimit dypalëshe e shumëpalëshe në fushën e problemeve të reagimit emergjent, arsimit, asistencës e të veprimeve të përbashkëta;
- Të emërojë Komandantin e Incidentit (KI do të ketë autoritet t'i lëshojë udhëzime Komandantëve të Incidentit në komuna), i cili është përgjegjës për koordinimin e operacioneve të përgjithshme emergjente;

Divizioni i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit - Detyrat prioritare të këtij divizioni janë mbikëqyrja, zhvillimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve operative të zjarrfikjes dhe shpëtimit në komuna, zbatimi dhe mbikëqyrja e rregulloreve dhe udhëzimeve të masave parandaluese nga zjarri, trajnimi dhe aftësimi i njësisve komunale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, ndihmon në zhvillimin e infrastrukturës së stacioneve të shërbimeve të zjarrfikjes dhe shpëtimit, në pajisje, trajnim dhe themelimin e stacioneve të reja.

Qendra Nacionale e Alarmimit dhe Koordinimi Emergjent-QNAKE I12, në strukturën e saj ka shefin e qendrës, tre sektorë: të operativës, të zhvillimit dhe mirëmbajtjes dhe sektorin për grumbullimin, përpunimin dhe arkivimin e të dhënave. Detyrë kryesore është të grumbullojë informacionet, analizojë dhe informojë institucionet përgjegjëse për fatkeqësitë të cilat kërcënojnë dhe rrezikojnë jetën e qytetarëve dhe mirëqenien e tyre, mbajtja nën kontroll e situatës së emergjencave civile në gjithë territorin, koordinimin i forcave operacionale për përballimin e emergjencave civile etj.

Divizioni i Planifikimit dhe Parandalimit në strukturën e tij ka dy sektorë: të Planifikimit dhe Parandalimit. Ndër detyrat kryesore të këtij divizioni janë planifikimi i emergjencave civile, këshillon dhe ndihmon komunat

për hartimin e planit të gatishmërisë emergjente dhe civile të komunës, përgatitë aktet ligjore dhe nënligjore për emergjencat civile, bën koordinimin me institucione dhe agjenci të tjera për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile, zhvillon dhe implementon programet e masave parandaluese emergjente.

Sfidat: Detyrë themelore si dhe e realizimit të Divizionit të Planifikimit Emergjent ka qenë themelimi i drejtorive komunale të Mbrojtjes Civile dhe Gatishmërisë Emergjente dhe sot ato funksionojnë pothuajse në të gjitha komunat duke mos e marrë parasysh veriun e Kosovës, Mitrovicën dhe tri komunat tjera më të vogla, të cilat në të ardhmen do të integrohen edhe ato në këtë sistem.

VLERËSIMET DHE ORIENTIMET, UDHËZIMET POLITIKE

Objektivat dhe politikat e Divizionit të Planifikimit Emergjent janë:

- Të zhvillojë planin e Reagimit Emergjent në mbarë Kosovën ;
- Vlerësim të besueshëm për veprimet e gatishmërisë në raste emergjente;
- Strukturë kombëtare të Menaxhimit të Emergjencave;
- Zhvillimi i Shërbimeve të Preventives dhe Operatives për fatkeqësitë në Kosovë;
- Ligjislaturë përkatëse për fatkeqësitë;
- Të ngrejë vetëdijesimin publik për reagimet emergjente, në veçanti për katastrofat natyrore dhe emergjencat tjera;
- Të vendosë standardet dhe udhëzimet unike në nivel vendi për Menaxhimin e Emergjencave;

PRIORITETET STRATEGJIKE DHE ZONAT E VEPRIMIT

Objektivat strategjike të Departamentit të Menaxhimit të Emergjencave brenda Ministrisë së Shërbimeve Publike të Qeverisë së Kosovës janë:

- Themelimi dhe mirëmbajtja e Shërbimeve të Preventivës dhe Reagimit Emergjent në Kosovë, duke përfshirë funksionet dhe resurset administrative dhe funksionale, duke pasur për qëllim parandalimin dhe kufizimin, si lëndimin në njerëz dhe dëmtimin e pronës dhe të ambientit;
- Bazueshmëria e sistemit mbi proceset e identifikimit të rrezikut dhe vlerësimit tek rajonet dhe komunat;
- Vlerësimi Global i Rrezikut;
- Ripërtëritja e Planeve Emergjente;

LISTA E PROJEKTEVE NË ZBATIM

Lista e projekteve :

1. Definimi, përcjellja si dhe plotësimi në formë të detajzuar të planeve të Vlerësimit të Rrezikut dhe planeve të Reagimit Emergjent;
2. Identifikimi i mangësive dhe më pastaj bëhet dizajnimi dhe përcaktimi i objektivave të secilit plan;
3. Mbajtja e takimeve të rregullta me zyrtarët e planifikimit komunal;
4. Aprovimi i projektligjit për Menaxhimin e Emergjencave;
5. Projekt – Udhëzimi për Planifikim Emergjent;

Themelore:

1. Përpilimi i planeve të Vlerësimit të Rrezikut
2. Përpilimi i planeve të Reagimit Emergjent
3. Analizat e rrezikut
4. Informimi i shoqërisë për menaxhimin e emergjencave

DOKUMENTACIONI EKZISTUES

(Lista e materialeve)

Në strukturën e vet ligjore DME-ja është e mangët
Arsyeja:Projektligji i pa aprovuar

Lista e materialeve:

1. Planet Vjetore të Sektorëve DME-së
2. Planifikimi strategjik - Zhvillimi i politikave
3. Plani i Rasteve të Paparashikuara për Kosovën